



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 12.06.2025  
Numër Protokolli: 4239/2025

A.nr.454/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj–Demi, anëtare, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.454/2025 të datës 12.03.2025 të parashtruar nga ankuesja L.I, kundër organit të punësimit: Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.06.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**Hedhet poshtë si e parakohshme** ankesa me numër A.nr.454/2025, e datës 12.03.2025, e parashtruar nga ankuesja, L.I.

## A r s y e t i m

Nëpunësja Civile, L.I (*tutje referuar vetëm* Ankuesja), më datë 17.12.2024 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6834/2024, të regjistruar nën shenjën A.nr.2007/2024 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për mos kompensim të shtesave për punë shtesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me datë 18.04.2025 ka dorëzuar përgjigjen në ankesë, se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Akti emërimit me numër të datës 23.12.2016, është e punësuar në pozitën “Zyrtare e Aviacionit të Përgjithshëm”, ndërsa përmes Vendimit me Nr.Ref.01/2022 të datës 12.01.2022, Vendimit me Nr.Ref.01/2023 të datës 17.01.2023 si dhe Vendimit Nr.Ref.01/2025 të datës 13.01.2025 është caktuar edhe për kryerjen e detyrave të punës për pozitën “Zyrtare Certifikuese/Aprovuese”-Alternative, në kuadër të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Si rrjedhojë, e mos kompensimit për kryerjen e detyrave shtesë, konkretisht punëve të *Zyrtares Certifikuese/Aprovuese*, ankuesja përmes shkresave elektronike zyrtare të datës 14.02.2025 dhe datës 04.03.2025, i është drejtuar U.D Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, duke kërkuar kompensimin për detyrat shtesë të përcaktuara sipas vendimeve të lartë theksuara.

Ndërsa, nga shkresat e lëndës rezulton se e ankuesja nuk ka pranuar përgjigje kundrejt kërkesave të saj, ashtu që e njëjta ka parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimin ankimor për kompensimin e shtesave nga data 27.10.2022 deri në 02.10.2024 (60 muaj), në vlerën prej e 20% të pagës bazë, andaj e njëjta kërkon aprovimin e ankesës me obligimin ligjor që organi i punësimit ta realizoj kompensimin e sapo theksuar ndaj saj.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës i’u referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: “1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ...”* e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankesa e ankueses e datës 12.03.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e paraafatshme, pasi që ankuesja ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës së parë të datës 14.02.2025 dhe kërkesës së fundit të datës 04.03.2025, dhe rrjedhimisht ende pa u përmbushur kriteri kohor lidhur me heshtjen administrative ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, mbi këtë bazë konstatimi, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankueses është pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të parakohshme, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.454/2025**

**Atdhe GASHI**

**Procesmbajtës**

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses L.I;
- Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës; dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.